

RELACION TOPOGRAFIK

OBJEKTI: " RIPROFILIM DHE MBUSHJE ME RËRË E VIJËS BREGDETARE NGA URA E
DAJLANIT DERI TEK GODINA E KAVALISHENCËS", DURRËS – FAZA I

RELACION TEKNIK MBI PUNIMET GJEODEZIKE DHE TOPOGRAFIKE

“RIPROFILIM DHE MBUSHJE ME RËRË E VIJËS BREGDETARE NGA URA E DAJLANIT DERI TEK GODINA E KAVALISHENCËS”, DURRËS

1. PERSHKRIMI I ZONES

Nga pikepamja planimetricke objekti shtrihet ne zonen bregdetare qe perfshin bregun e detit dhe siperfaqen nen nivelin e detit te cilat eshte lehtesisht e levishme dhe me varke si dhe pershkohet me rruge pergjithesisht te asfaltuara.

Nga ana altimetrike eshte terren i ulet, kuota minimale shkon deri ne $2.0 \div -6.0$ m .

2. MATERIALET QE U PERDOREN

Mbasi na u dhane detyrat e projektimit dhe ato specifike per relievet e detajuara zonen e projektit na u kerkuar qe ku eshte e mundur te jepet informacion per rrjetin ixhinierik ekzistues.

Para fillimit te punimeve topografike u siguruan materialet e nevojshme hartografike, gjeodezike si dhe paisjet perkatese, ne perputhje te plote me detyrat e projektimit.

Materialet hartografike na u dhane ne forme dixhitale si dhe nje pjese tyre e siguruam vete per te bere te mundur qe puna ne terren te jete sa efektive.

Punimet gjeodezike per projektimin e riprofilim dhe mbushje me rërrë e vijës bregdetare, u kryen mbi bazen e kerkesave teknike te pergjithshme dhe specifike te parashikuara nga Investitori.

a)Hartat Baze per Realizimin e Projektit:

Megënëse zona që do të projektohet shtrihet e gjitha në disa plansheta në shkallë 1:25 000 të kësaj zone, kemi përdorur hartën topografike të përgatitur nga instituti topografik i ushtrisë (ITU), azhurnimi i fundit në vitin 1987 që janë hartat topografike baze deri më sot.

Matjet gjeodezike për realizimin e projekt zbatimit janë kryer duke u bazuar në pikën baze si dhe duke kryer matje kontrolli të përafërta në pikat e triangolacionit .

Kontrolle të disniveleve janë bërë dhe në pikat (GCP 2015)

Keto janë pikat e bazamentit të fotografimit ajror të përdorur në vitin 2015 nga Autoriteti Shtetror për Informacionin Hapsinor (ASIG), që ndodhen në vende të dukshme në rrugë asfalti dhe me boje.

Matjet poligonale dhe ato të pikave detaje u kryen me GPS “SOKKIA GRX 1 GNSS”, stacion total të tipit LEICA 803 dhe Sonar 3D-15, të cilët teknikisht sigurojnë matjet e këndeve e largësive me saktësi e nevojshme për projektimin e veprave hidroteknike dhe batimetrinë e fundit të detit.

b) Instrumentat që u përdoren për punimeve topografike

“SOKKIA GRX 1 GNSS Receiver”

Sastësia e pozicionimit:

Statik:	$L1+L2 : 3\text{mm}+1.0 \text{ ppm} \times D / 10 \text{ mm} + 1.0\text{ppm} \times D$
Statik i shpejt:	$L1+L2 : 5\text{mm} + 1.0\text{ppm} \times D / 10\text{mm} + 1.5\text{mm} \times D$
Kinematik:	$L1+L2 : 15\text{mm} + 1.5\text{ppm} \times D / 30\text{mm} + 1.5\text{mm} \times D$
RTK:	$L1+L2 : 10\text{mm}+1.0\text{ppm} \times D / 20 \text{ mm} + 1.0\text{ppm} \times D$
DGPS:	<0.5m

Përpunimi i të dhënave: Sokkia Spectrum Field & Office software.



Stacioni Total **LEICA TCR 803 ULTRA**

TE DHENA TEKNIKE

3" (1.0 mgon) ne matjen kendore.



Ne matjen e distancave me keto parametra:

Matjet me reflektor.

Nga 1.5 deri ne 300m +/-(-1.5mm+2ppm)

mbi 300m +/-(-3mm +2ppm)

Matjet pa reflektor.

Nga 1.5 deri ne 500m +/-(-2mm+5ppm)

Perpunimi i te dhenave: Leica Construction Manager

Sonar 3D-15

Frekuenca e transmetimit 1,2 MHz

Fusha e shikimit horizontal 90° (±45°)

Fusha vertikale e shikimit 40° (±20°)

Thellesia maksimale 15 metra

Thellesia minimale 20 cm

Rezolucioni i rrezes 4 mm

Ndarja e rrezes 0,35° (horizontale) / 0,6°

Rezolucioni këndor 0,6° (horizontal) / 2,4° (vertikal)

Shpejtësia e përditësimit 5 Hz 20 Hz



Per realizimin e matjeve ne terren u bazuam ne keto parametra

1. Parametrat e Sistemit të Pozicionimit Global ALBCORS janë:

KRGJSH me parametrat e mëposhtëm:

-Sistemin Gjeodezik Referencë ETRS 89.

-Projeksioni TM.

-Elipsoidi referencë GRS- 80.

-Meridiani qëndror: $\lambda = 20^{\circ} 0'$ Gjatësi gjeografike lindore.

-Shkalla e shformimit në meridian: 1.

-Spostimi fals lindor: 500 000 m.

-Spostimi fals veri: 0 m.


-Realizimi ETRF200, Epoka (2014.177)

I. Sistemi i Lartësive.

Lartësitë janë Elipsoidale (h).

Koordinatat e Sistemit të Pozicionimit Global ALBCORS i gjejmë tek Gjeoportali Kombëtar, në linkun:

<https://geoportal.asig.gov.al/map/?auto=true>



2. Rrjeti i Pozicionimit Global ALBCORS:

R

rjeti Shtetëror Aktiv i Pozicionimit Global, ALBCORS, në varësi të metodës së matjeve dhe kushteve ideale të rlevimeve GNSS në terren garanton për përdoruesit e tij saktësinë e mëposhtme:

1. Për metodën RTK $\pm 2 - 3$ cm;
2. Për metodën PP ± 1 cm;

3. Rrjeti Nivelimit:

Për lidhjen me sistemin e lartësive duhet të përdoren pikat e rrjetit ALBCORS

3. Pershkrimi i punës së kryer për rlevimin e pjesës së bregut dhe zonës së shetitores

Para fillimit të punime (rlevimit) u krye njohja e detajuar e terrenit, e cila shërbeu për përcaktimin e sakte të metodikës, mënyrës e ndertimit të rrjetit gjeodezik, të rlevimit, si dhe organizimit të punës. Për mbështetjen e punimeve fillimisht u krijuan pikat e forta ku disa prej tyre që shërbyen edhe si baza gjatë gjithë rlevimit dhe një pjesë tjetër për kontrollë gjatë rlevimit.

Për të siguruar lidhjen gjeodezike unike të të gjithë projekteve u shfrytëzuan të dhënat gjeodezike të rrjetit ALBCORS. Sistemi që përdor Republika e Shqipërisë është projekcioni

Sistemi i Referimit KRRGJSH 2010

Rlevimi është bërë në këtë sistemin meqenëse në GPS kemi të instaluar software të cilët na e bëjnë të mundur të punojmë direkt në këtë sistem koordinativ dhe konkretisht baza fillestare u vendos në pikën e e forte të sistemit gjeodezik sipas KRRGJSH 2010

Me këtë sistem mund të përcaktohet lehtësisht koordinatat gjeodezike për çdo pikë mbi sipërfaqen tokësore nepermjet përdorimit të GPS si dhe përdorimin e hartave dixhitale ortofoto sidomos për pozicion planimetrik

Megënese behet fjale per te njejin projeksion dhe elipsoid dhe duke pare qe dhe gjate zbatimit te projekteve instrumenti gps po gjen nje perdorim mjaft te gjere e ben te mundur lehtesisht zbatimin e projektit mjafton qe projekti te jete dixhital dhe mund te insertohet lehtesisht ne instrument po ashtu behet shume e lehte edhe lidhja me Google Earth.

Duke u mbeshtetur ne pikat e poligonometrise u zhvillua rrjeti i matjeve topografike te planimetrise, matjet pergjate zones se bregut dhe zones se shetitores.

Ne matjen e pikave detaje eshte patur parasysh qe te maten ato pika qe paraqesin sa me sakte thyrjet horizontale dhe ato altimetrike te terrenit ne perputhje me kerkesat e pergjitheshme dhe specifike teknike te hartimit te projektit. Kjo u be e mundur ne bashkepunim me grupin studimor-projektus te konsulentit, dhe perfaqesues te investitorit.

Ne sektoret drejtezore eshte ruajtur largesia 15 – 30 metra, kurse ne kthesa jane matur pika me te detajuara. Jane kryer matje plotesuese ne te gjithe objektet ekzistuese. Ne trupin e rruges jane mare pika, ne dy anet e saj, ne bankinat dhe ne kanalet anesor.

Çdo pike e mare ne terren ka koordinata tre dimensionale, te paraqitura ne projekt. Gjate rikonicionit ne terren u vendosen pikat e poligonit dhe markat e nivelimit.

Pikat e fiksuara ne terren u plotesuan dhe me koordinata ne projeksioni KRRGJSH 2010

Keshtu per pikat poligonale deri ne 2km nga marresi baze u perdor intervali 20 sek me matje per çdo sekonde ndersa per largesi me te madhe deri ne 1 km intervali 40 sek.

3. Pershkrimi i punes se kryer per rilevimin e batimetrise

Rilevimi batimometrik është matja dhe përshkrimi i veçorive fizike në det të hapur dhe zonave bregdetare fqinje. GPS përdoret si një sistem kryesor pozicionimi dhe lidhet me pajisjen Sonar 3D-15 qe punon me një tingull dixhital me frekuence të vetme ose të dyfishtë per te regjistruar thellesine e ujit. Thellësia mblidhet çdo sekondë në një model të rregullt dhe ruhet me një pozicion GPS. Thellësitë korrigjohen për levizjen


e varkes, ndryshimin e baticës dhe shpejtësinë e zërit në ujë. Thellësitë e papërpunuara janë zvogëluar duke patur parasysh parametrat e baticës dhe kalibrimit nga lartësia e sipërfaqes për të percaktuar kuotat në fund të zonës së detit. Lartësitë përdoren për të krijuar një hartë konturore batimetrike dhe pamje 3-D.

Zona e matjes

Zona ku është bërë batimetria përfshihet në koordinatat e mëposhtme

Nr.	Veri	Jug
1	4,575,622.66	455,460.63
2	4,574,775.84	455,082.12
3	4,574,467.62	456,272.91
4	4,574,290.41	456,570.99
5	4,573,907.71	456,967.18
6	4,573,620.48	457,448.55
7	4,573,563.93	457,665.51
8	4,573,809.00	457,908.88
9	4,574,847.41	456,977.58
10	4,575,355.94	456,212.44

Koordinatat e zones se matjes projekcioni KRRGJSH 2010



Planimetria e matjes projekcioni KRRGJSH 2010

Zona e rilevuar bashke me bregun e detit eshte rreth 280 ha.

Per te kryer sa me sakte matjet batimetrike eshte bere dhe kontrolli i saktetise se matjeve te instrumentave duke marre per baze pike fikse ne zonen e bregut dhe ne baze te kesaj pike u kontrollua matjet me anen e nje late prane zones se bregut.

Ne fillim u rilevua me Sonar 3D-15 dhe u percaktua thellesia e pikes, dhe mepas e njejta pike u rilevua me anen e nje late hidrometrike duke gjetur thellesine e ujit.

Duke qene se fundi i detit ne zonen e projektit ka nje uniformitet kjo e percaktuar dhe nga batimetrite e meparshme, distanca mes pikave te matuar u percaktua nga 40 – 60 m ne zonen e bregut deri ne 110 – 130 m ne zonen e thellesise se detit .

Kushtet e motit dhe baticës ditore ishin shumë të ngjashme gjatë gjithë rilevimit. Baticat e larta në mëngjesin e hershëm përkonin me kushtet më të qeta të mëngjesit dhe nënkuptonin që mbulimi në breg mund të ruhej në një distancë të gjatë. Baticat në rënie përkonin vazhdimisht me fillimin e një flladi detar në mëngjes vonë në drejtim të kundërt dhe shkaktuan një sipërfaqe deti të turbullt dhe të lëkundur. Zonat më të thella u rilevuan më vonë në mëngjes gjatë rënies së baticës,





Pershkrimi fizik i zones.

Zona qe eshte rilevuar shtrihet ne zonen e Durresit dhe shtrihet nga kufiri Jugor i portit te Durresit e deri ne fundin e shetitores se re prane godines se Kavalishences . Zona qe u rilevua shtrihet ne nje teren bregdetar dhe nen ujqor per pjesen e batimetrise .Per me shume referohu planimetrise se pergjithshme te zones se rilevuar bashkangjitur ketij relacioni.

HARTOI

Ing. Sokol ALLARAJ





POROSITESI

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

KONSULENT

"TAULANT" shpk
 Design & Supervision
 adresa: Rr. "Gjike Kuqali", P.23/2, Ap.1, Tiranë

&

abkons "ABKONS" shpk
 LOCAL Knowledge GLOBAL Standards

SHENIME TEKNIKE

EMËRTIMI

"RIPROFILIM DHE MBUSHJE ME RËRË E VIJËS BREGDETARE NGA URA E DAJLANIT DERI TEK GODINA E KAVALISHENCËS", DURRËS"-FAZA I

ZONA

QARKU DURRËS
 BASHKIA DURRËS

FAZA E PROJEKTIT

PROJEKT ZBATIMI

EMERTIMI I FLETES

PLANIMETRIA E RILEVIMIT

PROJEKTI HIDROTEKNIK

Ing. Andrin KËRPAÇI
 Nr.Lic. K.1236/5

RILEVIMI TOPOGRAFIK

Ing.Sokol ALLARAJ
 Nr.Lic. T.0332/2


SHKALLA: 1:600

TIRANE 2024


NR.FLETES


2




VULA




POROSITESI FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT	
KONSULENT "TAULANT" shpk Design & Supervision "TAULANT" shpk adresa: Rr. "Gjika Kuqali", P.23/2, Ap.1, Tiranë & abkons "ABKONS" shpk LOCAL Knowledge GLOBAL Standards	
SHENIME TEKNIKE	
EMËRTIMI "RIPROFILIM DHE MBUSHJE ME RËRË E VIJËS BREGDETARE NGA URA E DAJLANIT DERI TEK GODINA E KAVALISHENCËS", DURRËS"-FAZA I	
ZONA	QARKU DURRËS BASHKIA DURRËS
FAZA E PROJEKTIT	PROJEKT ZBATIMI
EMËRTIMI I FLETES	PLANIMETRIA E RILEVIMIT
PROJEKTI HIDROTEKNIK	Ing. Andrin KËRPAÇI Nr.Lic. K.1236/5
RILEVIMI TOPOGRAFIK	Ing.Sokol ALLARAJ Nr.Lic. T.0332/2
SHKALLA: 1:600	NR.FLETES
TIRANE 2024	3
VULA	





POROSITESI  FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT	
KONSULENT  "TAULANT" shpk Design & Supervision adresa: Rr. "Gjike Kuqali", P.23/2, Ap.1, Tiranë &  "ABKONS" shpk LOCAL Knowledge GLOBAL Standards	
SHENIME TEKNIKE	
EMËRTIMI "RIPROFILIM DHE MBUSHJE ME RËRË E VIJËS BREGDETARE NGA URA E DAJLANIT DERI TEK GODINA E KAVALISHENCËS", DURRËS"-FAZA I	
ZONA	QARKU DURRËS BASHKIA DURRËS
FAZA E PROJEKTIT	PROJEKT ZBATIMI
EMËRTIMI I FLETES	PLANIMETRIA E RILEVIMIT
PROJEKTI HIDROTEKNIK	Ing. Andrin KËRPAÇI Nr.Lic. K.1236/5
RILEVIMI TOPOGRAFIK	Ing.Sokol ALLARAJ Nr.Lic. T.0332/2
SHKALLA: 1:600	NR.FLETES
TIRANE 2024	5
VULA	



POROSITESI

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

KONSULENT

TAULANT shpk
Design & Supervision
"TAULANT" shpk
adresa:
Rr. "Gjika Kugali", P.23/2, Ap.1, Tiranë

&

abkons "ABKONS" shpk
LOCAL Knowledge GLOBAL Standards

SHENIME TEKNIKE

EMËRTIMI

"RIPROFILIM DHE MBUSHJE ME RËRË E VIJËS BREGDETARE NGA URA E DAJLANIT DERI TEK GODINA E KAVALISHENCËS", DURRËS"-FAZA I

ZONA

QARKU DURRËS
BASHKIA DURRËS

FAZA E PROJEKTIT

PROJEKT ZBATIMI

EMERTIMI I FLETES

PLANIMETRIA E RILEVIMIT

PROJEKTI HIDROTEKNIK

Ing. Andrin KËRPAÇI
Nr.Lic. K.1236/5

RILEVIMI TOPOGRAFIK

Ing.Sokol ALLARAJ
Nr.Lic. T.0332/2

SHKALLA: 1:600

TIRANE 2024

NR.FLETES

6

VULA

